

UDHËZIM
Nr. 6/1, datë 15.5.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 25.2.2019 “PËR
FUNKSIONET, AUTORITETIN DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË
TATIMPAGUESVE, PROCEDURAT QË DO TË ZBATOHEN PREJ TIJ NË
MBROJTJE TË INTERESAVE TË TATIMPAGUESVE, SI DHE PROCEDURAT QË
DUHET TË NDIQEN NGA TATIMPAGUESIT, PËR TË PËRFITUAR MBROJTJEN E
TË DREJTAVE TË TYRE NGA AVOKATI I TATIMPAGUESVE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 105/2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 28.7.2010 “Për Avokatin e Tatimpaguesve”, i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Në pikën 2 “Organizimi i Avokatit të Tatimpaguesit”, pika 2.4, germa “b”, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“b) të ketë eksperiencë pune në administratën tatimore dhe/ose në pozicione pune që mbulojnë funksione politikëbërëse, rregullatore apo çështje juridike të administratës tatimore në ministrinë përgjegjëse për financat.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj